LIGJ
Nr.8346, datë 13.5.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7573, DATË 16.6.1992 "PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË PUSHTETIT LOKAL", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7593, DATË 29.7.1992, NR.7798, DATË 23.2.1994 DHE NR.8151, DATË 12.9.1996

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal ", ndryshuar me ligjet nr.7593, datë 29.7.1992, nr.7798, datë 23.2.1994 dhe nr.8151, datë 12.9.1996 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në fund të paragrafit të dytë të nenit 3, pas fjalëve "dënim me burg" shtohet fjalia "ose dënim plotësues, parashikuar nga pika 1 e nenit 30 të Kodit Penal."

Neni 2

Në nenin 9, pas paragrafit të dytë , shtohet një paragraf me këtë plërmbajtje:
"Në rast të zgjedhjeve të pjesshme, kategoria e shtetasve me banim të përkohshëm përcaktohet nga Këshilli i Ministrave."

Neni 3

Në nenin 24, pas paragrafit të tretë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Në rastet e zgjedhjeve të pjesshme, kur nuk krijohen komisione të zgjedhjeve të rretheve, komisionet e komunave e bashkive miratohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve jo më vonë se 25 ditë para ditës së votimeve, me propozim të partive politike dhe prefektit jo më vonë se 27 ditë përpara. Përbërja e komisionit caktohet sipas kritereve të përcaktuara në paragrafët e mësipërm të këtij neni."

Neni 4

Në nenin 30, në fund të gërmës "d", shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Në rastin e zgjedhjeve të pjesshrne, autorizimet për vëzhguesit e subjekteve elektorale në komisionet e komunave dhe bashkive i lëshon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 5

Në fund të paragrafit të dytë të nenit 29, pas fjalëve "partive politike", shtohen fjalët 35 ditë para datës së zgjedhjeve."
Pas paragrafit të dytë të nenit 29, shtohen këta paragrafë:
"Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve propozohet nga partia më e madhe e pozitës sdhe zëvendëskryetari nga partia më e madhe e opozitës. Zëvendëskryetari gëzon pozitë juridike të barabartë me kryetarin. Sekretari i komisionit është jurist dhe drejtor në Ministrinë e Pushtetit Lokal.
Vendet e anëtarëve të komisionit ndahen në mënyrë të barabartë midis partive politike pjesëtare të koalicionit qeveritar dhe të opozitës. Brenda këtyre ndarjeve vendet në komision zihen nga

përfaqësuesit e partive politike në përpjesëtim me rezultatet e arritura mesatarisht në zgjedhjet ë fundit në shkallë vendi për Kuvendin Popullor dhe organet e pushtetit lokal. Ndryshimet në përbërjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk mund të bëhen në 15 ditët e fundit para ditës së zgjedhjeve,përveç në rast vdekjeje ose dorëheqjeje.

Kur partia politike, së cilës i takojnë vende në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nuk paraqet kandidaturën përkatëse, atëherë vendet e saj zihen nga kandidatët e propozuar nga partitë e tjera politike, sipas radhës së përcaktuar në kriteret e këtij neni.

Neni 6

Në nenin 66, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Votimi fillon në orën $8.^{00}$ dhe mbyllet në orën $18.^{00}$. Nëse në orë $18.^{00}$ ka ende zgjedhes që presin të votojnë, votimi vazhdon deri sa të mbarojnë të gjithë të pranishmit. "

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.2093, datë 14.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani